

VENDIM
Nr. 675, datë 16.10.2019

PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 241, DATË 20.4.2018, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR MIRATIMIN E PLANIT TË VEPRIMIT 2018–2020, NË ZBATIM TË STRATEGJISË NDËRSEKTORIALE KUNDËR KORRUPSIONIT, 2015–2020, E TË PASAPORTËS SË INDIKATORËVE, KRIJIMIN, FUNKSIONIMIN DHE DETYRAT E KOMITETIT KOORDINATOR PËR ZBATIMIN E STRATEGJISË NDËRSEKTORIALE KUNDËR KORRUPSIONIT, 2015–2020, DHE TASK-FORCËS NDËRINSTITUCIONALE ANTIKORRUPSION”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, me propozimin e ministrit të Drejtësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr. 241, datë 20.4.2018, të Këshillit të Ministrave, bëhen ndryshimi dhe shtesa si më poshtë vijon:

1. Pika 4 ndryshohet si më poshtë vijon:

“4. Krijimin e Task-Forcës Ndërinstitucionale Antikorrupsion, përgjegjëse për inspektimet ndërinstitucionale, sipas planit të veprimit të Strategjisë Ndërsëktorale kundër Korrupsionit, e cila kryesohet nga ministri i Drejtësisë, Koordinator Kombëtar Antikorrupsion, dhe ka në përbërje këta anëtarë:

- Përfaqësues të kabinetit të Kryeministrit (koordinatori i ZOS-it);
- Drejtorin e Përgjithshëm të Agjencisë së Prokurimit Publik;
- Inspektorin e Përgjithshëm të Inspektoratit Qendror;
- Përfaqësuesin e Departamentit të Administrimit, Transparencës dhe Antikorrupsionit, në Kryeministri.”.

2. Në pikën 7, pas fjalisë së parë shtohet fjalia, me këtë përmbajtje:

“Në rast mungese të kryetarit, mbledhjet e Task-Forcës Ndërinstitucionale Antikorrupsion kryesohen nga zëvendësministri i Drejtësisë.”.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Erion Braçe